

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
SOUTH-EAST EUROPEAN UNIVERSITY
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА



FAKULTETI I BIZNESIT DHE EKONOMISË
FACULTY OF BUSINESS AND ECONOMY
ФАКУЛТЕТ ЗА БИЗНИС И ЕКОНОМИЈА

STUDIME PASDIPLOMIKE- CIKLI I DYTË

TEZA:

***NDIKIMI I INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE NË RRITJEN EKONOMIKE NË
MAQEDONINË E VERIUT***

KANDIDATI:

Elona Aliu

MENTOR:

Assoc.Prof.Dr Shpresa Syla

Tetovë, 2020

Mirënjohje

Në përfundim të këtij punimi i cili ishte një rrugëtim i gjatë, dëshiroj që të shpreh mirënjohje për të gjith ata që më ndihmuan dhe më kanë mbështetur që të arrijë në këtë ditë. Në rradhë të parë mirënjohja dhe falemenderimet shkojnë për mentoren time doc. Shpresa Syla që me përkushtim të madh më ka ndihmuar në përfundimin e këtij hulumtimi. Përveç mentorit tim, do të dëshiroja të falemenderoj anëtarët e komisionit **Prof. Dr. Shenaj Haxhimustafa** dhe **Prof. Dr. Selajdin Abdul** për durimin dhe bashkëpunimin që më ofruan gjatë përgatitjes së kësaj teze, por edhe për instruksionet që më sugjeruan të zgjeroja hulumtimet e mia nga perspektiva të ndryshme. Gjithashtu falenderoj me përzemërsi familjen time për inkurajimin e vazhdueshëm përgjatë çdo dite të jetës time.

Abstrakt

Investimet e huaja direkte janë një komponent shumë i rëndësishëm i aktivitetit ekonomik të një vendi. Qëllimi i këtij punimi janë investimet e huaja direkte, gjegjësisht analizim i përgjithshëm që lidhet me ndikimin e investimeve të huaja direkte në rritjen ekonomike të vendit tonë. Një ndër qëllimet kryesore të këtij punimi është të nxirren konkludime të sakta dhe të japim një pasqyrë sa më të qartë në lidhje me atë se sa efikase do të jenë investimet e huaja direkte dhe se si ato ndikojnë në rritjen ekonomike të vendit tonë. Nëpërmjet literaturës së gjerë, ne shohim se Investimet e Huaja Direkte janë një nga kanalet më të rëndësishme, përmes të cilave financimi ndërkombëtar rezulton në përfitime ekonomike. Në këtë punim ne paraqesim Investimet e Huaja Direkte në Maqedoninë e Veriut dhe i konsiderojmë Investimet e Huaja Direkte si lokomotivë të vendit, pasi ajo është e përqendruar në sektorë të rëndësishëm të ekonomisë së vendit tonë. Në këtë punim gjithashtu diskutuam faktorët që e bëjnë Maqedoninë e Veriut një vend më tërheqës për investorët e huaj.

Fjalët kyçe: Zhvillimi ekonomik, Rritja ekonomike, Investimet e Huaja direkte (IHD)

Апстрактни

Странските директни инвестиции се многу важна компонента на економската активност на една земја. Целта на овој труд е странските директни инвестиции, општа анализа поврзана со влијанието на странските директни инвестиции врз економскиот раст на нашата земја. Една од главните цели на овој труд е да се извлечат точни заклучоци и да се даде појасна слика за тоа колку ќе бидат ефикасните СДИ и како влијаат врз економскиот раст на нашата земја. Преку обемна литература, откриваме дека странските директни инвестиции се еден од најважните канали преку кои меѓународното финансирање резултира во економски придобивки. Во овој труд ги презентираме странските директни инвестиции во Северна Македонија и ги сметаме странските директни инвестиции како локомотива на земјата, бидејќи е насочена кон важни сектори во економијата на нашата земја. Во овој труд разговараме и за факторите што ја прават Северна Македонија попривлечно место за странските инвеститори.

Клучни зборови: Економски развој, Економски раст, Директни странски инвестиции (СДИ)

Abstract

Foreign direct investment is a very important component of a country's economic activity. The purpose of this paper is foreign direct investments, a general analysis related to the impact of foreign direct investments on the economic growth of our country. One of the main goals of this paper is to draw accurate conclusions and provide a clearer picture of how efficient FDI will be and how it impacts our country's economic growth. Through extensive literature, we find that Foreign Direct Investment is one of the most important channels through which international funding results in economic benefits. In this paper we present Foreign Direct Investment in Northern Macedonia and consider Foreign Direct Investment as a locomotive of the country, as it is focused on important sectors of our country's economy. In this paper we also discussed the factors that make Northern Macedonia a more attractive place for foreign investors.

Keywords: Economic Development, Economic Growth, Foreign Direct Investment (FDI)

Përmbajtja

Mirënjohje Error! Bookmark not defined.

Abstrakt..... Error! Bookmark not defined.

Апстрактни Error! Bookmark not defined.

Abstract..... Error! Bookmark not defined.

Përmbajtja 6

HYRJE:..... Error! Bookmark not defined.

Rëndësia e punimit Error! Bookmark not defined.

Metodologjia e punimit Error! Bookmark not defined.

Kapitulli i parë “Këndvështrimi teorik i IHD-ve” Error! Bookmark not defined.

-Koncepti dhe përkufizimi i investimeve të huaja direkteError! Bookmark not defined.

-Rëndësia e investimeve të huaja direkte.....Error! Bookmark not defined.

-Kostot dhe përfitimet që rrjedhin nga investimet ...Error! Bookmark not defined.

-Përfitimet e një vendi pritës nga IHD-të Error! Bookmark not defined.

-Efektet negative në vendin pritës nga IHD-të..... Error! Bookmark not defined.

-Avantazhet dhe disavantazhet e investimeve Error! Bookmark not defined.

-Avantazhet e investimeve të huaja direkte Error! Bookmark not defined.

-Disavantazhet e investimeve të huaja direkte..... Error! Bookmark not defined.

Kapitulli i dytë “Ndikimi i IHD-ve në zhvillimin ekonomik në Maqedoninë e Veriut” Error! Bookmark not defined.

-Ndikimi i IHD-ve në vendin tonë Error! Bookmark not defined.

-Klima e biznesit dhe investimet Error! Bookmark not defined.

-Arsyet për të investuar në Maqedoninë e Veriut Error! Bookmark not defined.

-Karakteristikat e IHD-ve..... Error! Bookmark not defined.

-Motivet që nxisin IHD-te në vendin tonë Error! Bookmark not defined.

Kapitulli i tretë “Kufizimet dhe pengesat për investime në Maqedoninë e Veriut”..... Error! Bookmark not defined.

-Kufizimet dhe pengesat për investime Error! Bookmark not defined.

-Faktorët kryesorë të IHD-ve	Error! Bookmark not defined.
-Masat që duhet të ndërmeren për ndërtimin e një mjedisi miqësor për afarizëm dhe investime	Error! Bookmark not defined.
Kapitulli i katërt “Analiza krahasimore e investimeve	Error! Bookmark not defined.
-Arsyet pse duhet të investohet në vendin tonë.....	Error! Bookmark not defined.
-Aspektet krahasimore të investimeve të huaja në rritjen ekonomike në Maqedoninë e Veriut	Error! Bookmark not defined.
-Të dhënat dhe metodologjia	Error! Bookmark not defined.
-Analiza e regresionit të thjeshtë linear	Error! Bookmark not defined.
-Vlerësimi i metodës (OLS).....	Error! Bookmark not defined.
-Modelet Fixed dhe Random Effect	Error! Bookmark not defined.
-Modeli Hausman Taylor.....	Error! Bookmark not defined.
-Interpretimi i rezultateve.....	Error! Bookmark not defined.
Konkluzione	Error! Bookmark not defined.
Literatura/Referencat	Error! Bookmark not defined.
Webfaqe.....	Error! Bookmark not defined.
Llogaritjet në Appendix.....	Error! Bookmark not defined.

HYRJE:

Rëndësia e punimit

Investimet e huaja direkte paraqesin mënyren më efektive për të krijuar vende të reja të punës në Maqedoninë e Veriut dhe për të krijuar rritje të qëndrueshme ekonomike në të ardhmen. Në kohën e sotme, bota ekonomike është duke i lënë ekonomitë kombëtare relativisht të izoluar dhe në vend të tyre synohet më shumë zhvillimi i ekonomive kombëtare përmes bashkëpunimit me vendet e tjera në tranzicion. Investimet e huaja direkte janë një segment i rëndësishëm i aktivitetit ekonomik të një vendi, për arsye të efekteve që sjellin në rritjen ekonomike. Investimet do të vazhdojnë të jenë një burim i rëndësishëm për Maqedoninë e Veriut duke pasur parasysh kushtet në të cilat duhet të realizohet zhvillimi ekonomik i vendit. Duke u mbështetur në këto arsye kam vendosur të shkruaj temën e lartpërmendur me shpresën se përmes saj do të trasoj një rrugë të re drejt studimit të këtyre aspekteve.

Metodologjia e punimit

Metodologjia e përdorur për përgatitjen e këtij punimi bazohet në një studim të kujdesshëm dhe hulumtime. Hulumtimi i kësaj teme është i mbështetur nga të dhëna dhe burime të ndryshme. Duhet të cekim se udhëzimet dhe këshillat e mentorit kanë rol të rëndësishëm në përpilimin e këtij punimi. Punimi nis me një trajtim teorik të IHD-ve për të vazhduar më tej me një analizë empirike të efektit të IHD-ve në zhvillimin ekonomik të Maqedonisë së Veriut. Korniza teorike është trajtuar sipas një literature të gjerë dhe bashkëkohore, ku përfshihen punime kërkimore shkencore, ndërsa metodat krahasuese janë aplikuar me krahasimin e investimeve të bëra në vendet e rajonit në periudha të caktuara. Për të përmbushur objektivat e punimit janë ndërmarrë rishikime të një literature të gjerë që ka të bëjë me shpjegimin e kësaj lëmie, poashtu janë shfrytëzuar edhe studimet e instituteve kërkimore-shkencore, raportet vjetore të institucioneve të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, si dhe burime dytësore që përfshijnë studime të mëparshme dhe raste studimi në këtë fushë, raporte, tabela statistikore, baza të dhënash kërkime në internet etj.

Kapitulli i parë “Këndvështrimi teorik i IHD-ve”

-Koncepti dhe përkufizimi i investimeve të huaja direkte

Ekzistojnë përkufizime të ndryshme në lidhje me investimet e huaja direkte, për shkak të natyrës dhe karakterin e ndryshimit të investimeve. Investimi i huaj direkt (IHD), në formën klasike përkufizohet si një investim fizik që një sipërmarrës i huaj investon në një vend jo të origjinës, duke angazhuar fondet e tij financiare, me synim kthim nga ky investim. OECD (2008) Investimet e huaja direkte përkufizohen si: “një investim i bërë nga një kompani në një vend resident jo të origjinës, me qëllim përfitimi në afatgjatë, nga ky investim”

Përkufizim: *Investimet e huaja direkte janë një kategori investimi nga sipërmarrje rezidente (investitor direkt) në një ekonomi, me interes afatgjatë biznesi në një ekonomi tjetër nga vendi i origjinës së investitorit direkt.*

Investimet e huaja direkte janë një element kyç në integrimin ekonomik ndërkombëtar. Ato krijojnë lidhje të drejtpërdrejta, të qëndrueshme dhe afatgjate ndërmjet ekonomive, dhe lejojnë ekonomitë të promovojnë produktet e tyre në tregjet ndërkombëtare. Investimet e huaja direkte janë investime të cilat realizohen nga investitorë të huaj, pra janë investime të faktorëve të prodhimit që i kalon kufijtë shtetëror të një vendi, me qëllim të përfitimit të sasisë më të madhe të të mirave materiale. Këto investime realizohen jashtë kufijve shtetëror me një strategji të biznesit dhe me rol “aktiv” në udhëheqjen dhe kontrollin e pasurisë. Investitori i këtill, përveç kapitalit investon edhe në teknologji (mjete të punës), arsim, edukim dhe shprehi të punës. Vendi i blerësit ose i aksionarit njihet me emrin “vendi shtëpiak”, ndërsa vendi ku është blerë firma quhet “vendi mikpritës” (Selimi, N.S. 2008, *Globalizmi Ekonomik. Tetovë*).

Kuptimi i investimeve në kuptimin e plotë të fjalës mund të përkufizohet si angazhim i mjeteve financiare, apo i të mirave të tjera material të shprehura financiarisht për realizimin e qëllimeve zhvillimore. Angazhimi i mjeteve financiare mund të bëhet në patundshmëri, letra me vlerë, përsosje të proceseve teknologjike, arsimimin e personelit punues etj. Në rast se angazhimi i mjeteve financiare, apo i të mirave që mund të vlerësohen financiarisht bëhet nga partneri i huaj, atëherë investimet e tilla llogariten si investime të huaja (Jashari, A.J. 2016. *E Drejta Afariste. Tetovë*). Investimi i kapitalit të huaj në ekonomitë e shteteve të ndryshme, mund të bëhet në tri forma edhe atë: nëpërmjet investimeve direkte dhe investimeve indirekte, nëpërmjet kredive dhe huave dhe llojeve të ndryshme të ndihmave.

Investimet e huaja direkte janë një nga faktorët më të rëndësishëm ndërkombëtarë në lidhje me lëvizjet e parasë, poashtu janë një burim i ri për punësim në vendet ku papunësia paraqet problem serioz shoqëror. Këto investimet zakonisht bëhen në ekonomi të hapura që ofrojnë një fuqi punëtore të kualifikuar dhe perspektivë mbi mesataren e rritjes për investitorin, në krahasim me ekonomitë e rregulluara mirë. Investimet e huaja direkte, padyshim janë një ndër faktorët kryesorë që nxitën zhvillimin e ekonomisë botërore në globalizimin ekonomik. Tregu së bashku me investimet e drejtpërdrejta të huaja janë të njohura si forca motorike e rritjes ekonomike dhe forcë e fuqishme e integritit global.

Në periudha të ndryshme të shoqërisë njerëzore IHD-ja ka pasur formë dhe intensitet të ndryshëm. Fillet e kësaj veprimtarie ekonomike i gjejmë qysh në shekullin e 16-të, por me zhvillimin e kapitalizmit rëndësia e saj gjithnjë e më tepër rritet. Në fillim të shekullit njëzet kalimi i kapitalit përtej kufijve shtetërorë realizohej kryesisht nëpërmjet ndërmjetëzimit të tregut ndërkombëtar të kapitalit, në formë të huas, investimeve portfolio, por edhe të IHD-te. Financimi ndërkombëtar gjatë kësaj kohe nuk kishte për qëllim vetë fitimin, por shpesh herë në vete përmbante edhe qëllime politike që shfrytëzoheshin nga shtetet e zhvilluara, si Britania e Madhe, Franca, Gjermania etj. IHD-të e shteteve të Europës Perëndimore kryesisht financonin minierat, plantacionet, portet, infrastrukturën në vendet afrikane dhe ato të Amerikës Latine. Britania e madhe, e cila ishte fuqi botërore para Luftës së parë Botërore, dominonte në biznesin ndërkombëtarë dhe posedonte 45% të stokut botëror të IHD-së në vitin 1914 (*Wafo, K.W. 1998. Political Risk and FDI, Konstanz*).

-Rëndësia e investimeve të huaja direkte

Investimet e huaja direkte janë çështje të rëndësishme ekonomike në një vend, ku në kohët e fundit në veçanti shtetet në zhvillim mundohen sa më shumë për të tërhequr investime të huaja. Investimi i huaj direkt është transferimi i investimeve të huaja direkte jashtë vendit, pasi është një element i rëndësishëm në strategjinë e tyre të përgjithshme për zhvillimin ekonomik. Investimet e huaja direkte janë dukuri e re në marrëdhëniet ndërkombëtare ekonomike. Këto dukuri rrjedhin prej të drejtës anglosaksone mbi të drejtën e shoqërive tregtare të cilët pas luftës së dytë botërore janë shpërndarë pothuajse në të gjithë sistemet juridike dhe ekonomike të botës. Ky proces, shumë është përshpejtuar me zhvillimin e shpejtë të kompanive multinacionale, të cilët kontrollojnë direkt apo indirekt disa degë të ekonomisë. Në dekadën e parë të këtij shekulli, në të drejtën tregtare dhe ato bankare ka qenë dominante nocioni portfolio investime dhe portfolio capital, mirpo sot këto nocione janë tejkaluar dhe gjithnjë e më tepër po bëhet fjalë për investimet direkte (*Jashari, A.D. 2016. E Drejta Afariste. Tetovë*).

Mbisundon mendimi se investimet e huaja direkte janë investime të cilët investitori i huaj investon në formë materiale, ose jo materiale në një afat të gjatë në shoqëritë dhe vendet e huaja, në bazë të së cilës siguron të drejtën që të udhëheq me shoqëritë ku ka investuar duke pasur kështu rol aktiv në punën e shoqërisë. Mënyrë më e shpeshtë që të mund të sigurohet e drejta në udhëheqjen me shoqërinë ku investohet është mënyra e sigurimit të paketit kontrollues të aksioneve, apo në bazë të kontrollit efektiv të pasurisë (*Jashari, A.D. 2016. E Drejta Afariste. Tetovë*). Tek investimet e huaja qëllimi kryesor i investitorit është vendosja e përhershme e kontrollit ekonomik, ose realizimi i së drejtës në menaxhim me subjektin ekonomik në të cilën investon.

Investimet e huaja kanë rëndësi shumë të madhe për ekonominë e vogla dhe në zhvillim përse i përket kontributit që japin ato në prodhim, punësim dhe rritje të nivelit të jetesës. IHD-te janë një pjesë thelbësore e një ekonomie të hapur dhe një lehtësues kryesorë për zhvillimin e një vendi. Kjo mund të ndihmojë kombet në mbarë botën, për të hyrë në tregjet ndërkombëtare, në teknologji, mund të veprojnë si një burim i rritjes dhe modernizimit të ekonomisë, rritjes së të ardhurave dhe modernizimin, rritjes së të ardhurave dhe punësimit. Ato janë një prej nxitësve kryesorë të rritjes ekonomike në vend.

Këto investime kontribuojnë në shumë gjëra:

- Për të zgjeruar bazën e investimeve në vend;
- Për zgjidhjen e problemit të papunësisë duke krijuar mundësi të reja të punësimit;
- Futja e teknologjisë së përparuar në vend, për të mësuar mbi modernitetin, metodat e menaxhimit, komunikimit dhe marketingut.

Të gjitha këto çojnë drejt punësimit kombëtarë të fitojnë aftësi dhe përvojë pune më të lartë. Pasi çdo shtet është i vetëdijshëm për rëndësinë e investimeve të huaja direkte, gjithnjë kërkojnë të tërheqën sa më shumë investime të huaja, duke krijuar një atmosferë të favorshme për investimet e huaja, si dhe sigurimin e lehtësive dhe nxitjeve për investitorët e huaj. Investitorët e huaj gjatë viteve të fundit janë mjaftë aktiv. Ato me aktivitetet ekonomike që kanë ndërmarë, luajnë një rol të madh në zhvillimin e shumë ekonomive të vendeve të botës. Ndikimi i tyre në nivelin e tanishëm të zhvillimit ekonomik në botë është i pranuar edhe nga shtetet më të izoluar. IHD-ja paraqet burim të ri dhe të mirëseardhur për punësim, në vendet ku papunësia paraqet problem serioz shoqëror (*Selimi, N.S. 2008. Globalizmi Ekonomik. Tetovë*).

-Kostot dhe përfitimet që rrjedhin nga investimet

Ajo çfarë është me interes të lartë në përcaktimin e kostove dhe përfitimeve që rrjedhin nga investimet e bëra, lidhet e gjitha me ekonominë e vendit pritës, megjithatë edhe vendi i origjinës së investitorit të huaj mund të shoqërohet me përfitime ose kosto.

Investimet e huaja direkte kanë pasur dhe kanë rëndësi të veçantë në transformimin e tregjeve të vendeve në zhvillim. Në vazhdim do të përmendim disa përfitime që ka vendi pritës:

-Përfitimet e një vendi pritës nga IHD-të

- Flukset e IHD-ve nuk ndikojnë në krijimin e borxhit në një ekonomi dhe janë një mjet shumë efikas për të financuar defiçitin e tregtisë jashtë të një vendi pritës, veçanarisht për vendet në zhvillim;
- IHD-të në ekonominë në tranzicion ose ekonomi në zhvillim, shikohen si burim ekonomik që mund të përmbushin jo vetëm nevojat korente, por më shumë nevojat strategjike;
- Investimet e huaja direkte kontribojnë në zhvillimin e tregjeve edhe në lindjen e sektorëve të rinj në vendin pritës;
- IHD-të ndikojnë në ruajtjen e stabilitetit të sektorit, nëse zënë pjesën më të madhe të kapitalit të investuar në një sektor ekonomie të vendit pritës;
- IHD-të sjellin një shpërndarje dhe rritje të produktivitetit total në ekonominë e vendeve pritëse;
- IHD-të shpesh herë shërbejnë si një promocion për donator të ndryshëm apo organizata ndërkombëtare, që mund të investojnë në një vend pritës.

Vendi mikpritës i cili mirëpret investimet e huaja direkte përveç përfitimeve, kuptohet se ka edhe anët negative.

-Efektet negative në vendin pritës nga IHD-të

- Efektet negative në treg;
- Efektet negative në bilancin e pagesave si dhe
- Humbjen e sovranitetit dhe autonomies kombëtare.

-Avantazhet dhe disavantazhet e investimeve

Investimi në ekonominë e një vendi tjetër, blerja në një kompani të huaj ose zgjerimi i biznesit jashtë vendit mund të jetë jashtëzakonisht e dobishme financiare dhe mund t'ju ofrojë nxitjen e nevojshme për të kaluar në një nivel të ri suksesi në atë vend. Investimet e huaja direkte gjithashtu mbartin edhe rreziqet e veta, poashtu është edhe shumë e rëndësishme për një investitor që të shikojë klimën ekonomike përpara se të investoj. Mos harojmë se ne jetojmë në një ekonomi gjithnjë e më të globalizuar, kështu që IHD-te do të bëhen një mundësi më e aritshme kur bëhet fjalë për biznesin. Në vazhdim do të përmendim disa avantazhe dhe disavantazhe të investimeve të huaja direkte.

-Avantazhet e investimeve të huaja direkte:

- **Stimulimi i zhvillimit ekonomik**- investimi i drejtpërdrejtë i huaj mund të stimuloj zhvillimin ekonomik të vendit të synuar, duke krijuar një mjedis më të favorshëm për investitorin dhe përfitime për industrinë vendase.
- **Tregtia e lehtë ndërkombëtare**- zakonisht, një vend ka tarifën e vet të importit, dhe kjo është një nga arsytet pse tregëtimi me të është mjaftë i vështirë. Gjithashtu, ka industri që zakonisht kërkojnë praninë e tyre në tregjet ndërkombëtare për të siguruar që shitjet e tyre dhe qëllimet e tyre do të përmbushen plotësisht. Me IHD-te të gjitha këto do të bëhen më të lehta.
- **Punësimi dhe rritja ekonomike**- investimi i drejtpërdrejtë i huaj krijon vende të reja pune, pasi investitorët ndërtojnë kompani të reja në vendin e synuar, krijojnë mundësi të reja. Kjo çon në një rritje të të ardhurave dhe më shumë fuqi blerëse për njerzit e cila nga ana tjetër çon në një rritje ekonomike.
- **Zhvillimi i burimeve njerzore**- një avantazh i madh i sjellë nga trajnimi dhe shkëmbimi i përvojës do të rrisin arsimimin dhe kapitalin e përgjithshëm njerzor të një vendi. Duke pasur parasysh këto, një vend me IHD mund të përfitoj shumë duke zhvilluar burimet e tij njerzore dhe duke ruajtur pronësinë.
- **Transferimi i burimeve**- investimi drejtpërdrejtë i huaj do të lejojë transfrimin e burimeve dhe shkëmbime të tjera të njohurive, ku vendeve të ndryshme u jepet qasje në teknologji dhe aftësi të reja.
- **Prodhueshmëria e rritur**- objektet dhe pajisjet e ofruara nga investitorët e huaj mund të rrisin produktivitetin e një fuqie puntore në vendin e synuar.
- **Rritja e të ardhurave**- një tjetër avantazh i madhë i investimeve të huaja direkte është rritja e të ardhurave të vendit të synuar. Me më shumë punë dhe paga më të larta të ardhurat kombëtare rriten normalisht. Si rezultat, rritja ekonomike nxitet. Kini parasysh që korporatat më të mëdha zakonisht ofrojnë nivele më të larta pagash sesa ato që normalisht do të gjeni në vendin e synuar, gjë që mund të çojë në rritje të të ardhurave.

- IHD është zhvillimi i burimeve njerzore të kapitalit, i cili shpesh nënvlerësohet pasi nuk është menjëherë i dukshëm. Kapitali njerzorë është kompetence dhe njohuri e atyre që janë në gjendje të kryejnë punë, më shumë të njohur për ne si fuqia punëtore.
(Regoli, N.R(2018, Jul 23) marrë nga <https://connectusfund.org/17-big-advantages-and-disadvantages-of-foreign-direct-investment>).

-Disavantazhet e investimeve të huaja direkte:

- **Rreziku nga ndryshimet politike-** për shkak se çështjet politike në vendet tjera mund të ndryshojnë menjëherë, investimet e huaja direkte janë shumë të rrezikshme. Shumica e faktorëve të rrezikut që do të përjetoni janë jashtëzakonisht të larta.
- **Ndikimi negativ në normat e këmbimit-** investimet e huaja direkte her pas here mund të ndikojnë në kurset e këmbimit në favor të një vendi dhe në dëm të një vendi tjetër.
- **Kosto më të larta-** nëse investoni në disa vende të huaja, mund të vini re se është më e kushtetueshme sesa kur eksportoni mallra, pra është shumë e domosdoshme të përgatitni para të mjaftueshme për të vendosur operacionet tuaja.
- **Ndikimi negativ në investimin e vendit-** rregullat që rregullojnë kurset e këmbimit të huaj dhe investimet direkte mund të ndikojnë negativisht në vendin investues. Investimet mund të ndalohen në disa tregje të huaja, që do të thotë se është e pamundur të gjesht një mundësi ftuese.
- **Mos-qëndrueshmëri ekonomike-** duke marrë parasysh që investimet e huaja direkte mund të jenë me kapital intenziv nga këndvështrimi i investitorit, ndonjëherë mund të jetë shumë i rrezikshëm ose ekonomikisht jo i zbatueshëm. (Regoli, N.R. 2018, Jul 23) marrë nga: <https://connectusfund.org/17-big-advantages-and-disadvantages-of-foreign-direct-investment>)

Kapitulli i dytë “Ndikimi i IHD-ve në zhvillimin ekonomik në Maqedoninë e Veriut”

-Ndikimi i IHD-ve në vendin tonë

Investimet e huaja direkte kanë një rëndësi të madhe në zhvillimin e ecurive ekonomike të Maqedonisë së Veriut. Ato çmohen edhe me avancimin e procesit të prodhimit, transferimit të teknologjisë, shfrytëzimit optimal të kapaciteteve prodhuese, si dhe organizimit më të mirë të punës. Si një ekonomi e vogël, megjithëse e hapur, Maqedonia e Veriut vazhdon të ndërmarë hapa për të tërhequr sa më shumë investime të huaja direkte. Vendi gjithashtu ka zhvilluar një politikë të tregtisë së jashtme shumë të liberalizuar dhe ka nënshkruar marrëveshje të ndryshme dypalëshe që u japin prodhuesve vendas qasje të lirë në Bashkimin Europian dhe tregjet e tjera, duke u bërë Maqedonia e Veriut një platformë prodhimi dhe eksporti shumë konkurrues. Investimet e huaja direkte vitet e fundit kanë ndikuar shumë pozitivisht në Maqedoninë e Veriut, kanë ndikuar si në rritjen ekonomike të vendit poashtu edhe papunësi.

Poashtu nga “Raporti i Investimeve Botërore 2019” në konferencën e Kombeve të Bashkuara për tregti dhe zhvillim tregon se vendi ynë Maqedonia e Veriut vitin e kaluar pati rritjen më të lartë të investimeve të huaja në Ballkanin Perëndimor. Në vetëm një vit, investimi i drejtpërdrejtë i huaj në vendin tonë u rrit me 20 përqind, nga 205 milion në 2017, në 737 milion dollarë në 2018, sipas raportit. Me këtë rritëm të ritjes, vendi ynë është bindshëm i pari për sa i përket rritjes së investimeve të huaja direkte si në rajon ashtu edhe në mesin e të gjitha vendeve pas tranzicionit të përfshira në raportin e Kombeve të Bashkuara.

Përveç rritjes ekonomike, në 4.1 përqind të PBB-së rënia e papunisë në një 17.8 përqind historikisht më të ulët raporti i Konferencës së Kombeve të Bashkuara është një tregues tjetër që ekonomia është konkurruese dhe po shkon në drejtimin e duhur. Investimet e huaja direkte gjithnjë e më tepër luajnë rol të rëndësishëm në ekonominë botërore. Ky sukses është një motiv shtesë për zbatimin e masave që sigurojnë një rritje më të fortë ekonomike dhe një standard më të lartë jetese për të gjithë.


Në vazhdim do paraqes një tabelë me investimet e huaja direkte, që kanë qenë në Maqedoninë Veriore si dhe në disa vende tjera në tranzicion, ku me këto të dhëna në fund të punimit do bëjmë analizë empirike nëpërmjet programit Stata.

Tabela 1: Shkalla e investimeve të huaja direkte në vendet në tranzicion

Vitet	Shqipëria	Maqedonia e Veriut	Sllovenia	Kroacia	Hungaria	Turqia
2006	75.46	344.8	15.8	372.4	1315.3	276
2007	220.35	105.64	38.3	564.6	1137.5	694
2008	213.1	18.83	81.9	285	728.6	993
2009	302.5	11.24	36.7	908.4	35.1	344
2010	253.6	20.91	230.8	424.1	734.3	598
2011	170.2	58.95	-19.9	382.1	-59.8	375
2012	133.8	-4.6	-25.4	294.2	1882	646
2013	298.48	15.36	32.6	83	-1617.8	918
2014	256.47	32.99	-38	367.1	1922.5	722
2015	254.91	-13.18	0.4	153.2	1790.6	1459
2016	249.53	29	12.5	660.7	1952.7	495
2017	293	33.55	71.4	583.3	276.1	304
2018	268.58	71.95	68.8	115.5	2349.6	648
2019	272	140.07	76	485.3	1426.9	275


Burimi: www.tradingeconomics.com

Grafikoni 1: Investimet e huaja direkte në vendet në tranzicin



Burimi: kalkulimi nga vetë autori duke përdorur softuerin statistikor "Stata"

Grafikoni 1.2 Mesatarja e Investimeve të huaja direkte



Burimi: të kalkuluara nga vet autori

Duke u bazuar në të dhënat tona që kemi marrë shohim se Shqipëria edhe pse ka pasur ulje në vitin 2006 me 75.46% të investimeve, në vitin 2019 ka arritur me 272%. Maqedonia Veriore edhe pse ka pasur rritje në fillim të vitit 2006 ku investimet kanë qenë 344.8%, në vitet në vazhdim ka pasur ulje të madhe ku në disa vite në 2015 arrin me-13.18% ndërsa ku në vitin 2019 arrin me 140.07%. Poashtu edhe Sllovenia në fillim të viteve që ne kemi marrë në tabelë ka pasur një ulje, ku më pas në vitet në vazhdim ka ngritje të investimeve ku arrin me 76% në 2019. Kroacia, Hungaria dhe Turqia kanë pasur lëkundje të investimeve të huaja direkte, ku Kroacia në fillim të viteve ka pasur 372.4%, ndërsa në vitin 2019 arrin me 485.3%, kurse Hungaria dhe Turqia në vitet 2006 kanë 1315.3% dhe 276%, ndërsa në vitet më tej vazhdon të kenë ulje, dhe në 2019 arrin me 1426.9% dhe 275%. Në vendet në tranzicion shohim se Hungaria dhe Turqia dalin shtetet më favorite me mesatare më të lartë me 990.97143% si dhe 624.78571%.

-Klima e biznesit dhe investimet

Përkufizimi i klimës së biznesit është mjedisi ekonomik dhe profesional që rrethon një industri ose një grup ndërmarrjesh biznesi. Kjo përfshinë qeverinë dhe qëndrimin politik ndaj bizneseve të tilla, mbështetjen e tyre për organizatat e punës dhe stabilitetin e tyre financiar, midis aspekteve të tjera.

Çka kuptojmë me klimen e biznesit? Kur vlerësoni klimen e biznesit të një kompanie të caktuar ose të një industrie të tërë, duhet të merrni parasysh këto: efektet e mundshme të inflacionit, praktikat tatimore, marrëdhëniet midis sindiatave dhe punëdhënësve, marrëdhëniet midis institucioneve financiare dhe bizneseve, shëndeti i organizatave të punës, qëndrimet politike ndaj biznesit. Kompanitë që duan të jenë pjesë e një klime të mirë biznesi duhet të punojnë për të. Ata duhet të jenë në përputhje me taksat, inovacionin, krijimin e vendeve të punës, kompenzimin e mire të punonjësve etj.

Rritja e besimit në ekonomi! Shkalla e papunësis është e ulët, dhe ekonomia është rritur më shumë gjatë disa viteve të fundit. Shumë biznese të vogla kanë sukses dhe shitjet janë në treg, pronarët e bizneseve po mendojnë për zgjerimin e bizneseve. Me një besim në rritje në ekonomi, më shumë pronarë të bizneseve po marrin hua dhe japin më shumë duqane, kjo krijon vende pune, më shumë të ardhura dhe mbështet industrinë bankare. Gjatë viteve të kaluara, qeveritë e ndryshme kanë ulur me sukses deficitet fiskale dhe ato janë përqendruar në ruajtjen e një niveli të ulët të inflacionit, një kurs të qëndrueshëm denar-euro dhe normave të ulëta të interesit. Megjithatë këto më sipër kanë mundësuar zhvillimin e një mjedisi të qëndrueshëm makroekonomik, vendi nuk ka qenë aq i suksesshëm në rifillimin e rritjes së saj ekonomike. Edhe, pse pozitive normat e rritjes të regjistruara gjatë viteve të fundit janë akoma prapa pritjeve, dhe më të ulëta se ato të vendeve më dinamike të rajonit. Objektivat e përcaktuara në të ardhmen e qeverisë do të jenë të mbështesin rritjen e konsumit të brendshëm, prodhimin industrial dhe krijimin e një mjedisi të favorshëm për investime të huaja dhe vendase. Për të arritur këtë, qeveria tashmë ka zbatuar dhe është ende në zhvillim, duke përfshirë:

- Reformimin e mëtejshëm të sektorit publik, duke përfshirë futjen e investimeve të sektorit privat në sektorët e shërbimeve publike dhe infrastrukturës;
- Vazhdimi i politikave të liberalizimit të tregtisë;
- Masat që synojnë të mundësojnë qasje më të lehtë në financim;
- Zbatimi i stimuljeve tatimor përmes krijimit të zonave pa taksë dhe uljes së përgjithshme të barrës tatimore.

Vitet e fundit investitorët e huaj në Maqedoninë e Veriut nuk janë shumë të kënaqur, pasi mungesa e kuadrit të kualifikuar, klima e paparashikueshme e biznesit, ndërimi i shpesht i ligjeve, investimet e pamjaftueshme në infrastrukturë, mungesa e reformave strukturore janë problemet më të mëdha me të cilat ballafaqohen kompanitë e huaja që punojnë në Maqedoninë e Veriut, këto janë disa nga vërejtjet që i janë dhënë qeverisë në Shkup nga këshilli për investitorë të huaj.

Klima e biznesit jo vetëm në Maqedoninë e Veriut por në të gjithë vendet është e ndryshueshme. Ndërsa teknologjia vazhdon të zhvillohet dhe dëshirat, preferencat e konsumatorëve

ndryshojnë, fillimi i një biznesi në klimën e tanishme duket shumë ndryshe nga së bëri dhjetë vjet më parë. Sipërmarrësit duhet ti marrin parasysh këto ndryshime kur përgatiten për të hyrë në treg dhe sa më të përgatitur të jenë ata për ndryshime, aq më të suksesshëm do të jenë. Strategjitë e marketingut janë duke ndryshuar, dhe madje edhe mënyra se si ne blejmë dhe shesim mallra po ndryshon. Dyqani fizik po bëhet një gjë e së kaluarës ndërsa gjithnjë e më shumë kompani në internet shfaqen. Industri të ndryshme preken në mënyra të ndryshme. Është e rëndësishme të keni një kuptim të mirë të industrisë suaj dhe ndryshimet specifike që ndikojnë në të. Hulumtimi i klimave të biznesit është një domosdoshmëri për të gjithë pronarët e biznesit.


-Arsyet për të investuar në Maqedoninë e Veriut

Edhe Maqedonia e Veriut është bërë pjesë e një gare globale dhe rajonale “nga poshtë-lartë” se kush do të ofrojë më shumë për të tërhequr investitorë të huaj përmes çregullimeve më të mëdha ose stimujve më të lartë. Vitet e fundit Maqedonia është zhvilluar me sukses si një destinacion tërheqës për investime të huaja direkte në rajon në një konkurrencë të fortë me një numër të konsiderueshëm vendesh. Këto janë disa fakte se pse duhet të investohet në Maqedoninë e Veriut: (Vila, A. 2019, marrë nga <https://www.netherlandsworldwide.nl/countries/north-macedonia/doing-business/why-invest-in-macedonia/labor-market>).

- Maqedonia e Veriut është vendi i parë në Evropën Juglindore që nënshkruan marrëveshjen e stabilizimit, asociimit me Bashkimin Evropian në 2011- Marrëveshja e Stabilizimit Asociimit me BE;
- Infrastrukturë e shkëlqyeshme;
- Vendi kandidat i BE-së;
- Maqedonia e Veriut ka nënshkruar një protokoll për pranimin në NATO në 6 Shkurt 2019;
- Regjistrimi i shpejt i ndërmarrjes;
- Pagesa elektronike e taksave;
- Taksat më të ulëta në Evropë;
- Fuqia e aftë në dizpozicion;
- Cilësia e lartë e jetës;
- Stabilitet politik, stabilitet monetar, stabilitet makroekonomik;
- Qeveria e orientuar nga biznesi.

Në grafikonin më poshtë do të shohim taksat në disa shtete të Europës:

Taksat në Europë. Burimi: bazuar në Bankën Botërore për bërjen e biznesit 2019



Me reformat e fundit ekonomike, Maqedonia e Veriut ka krijuar paketën më tërheqëse të taksave në Europë. Këto reforma përfshijnë 10% taksë mbi të ardhurat e korporatave dhe 10% deri 18% taksa personale të të ardhurave, të cilat thjeshtësojnë sistemin e taksave dhe stimulojnë kompanitë e suksesshme për të përmisuar më tej operacionet dhe për të ritur përfitimin. Nga kjo konkludojmë se në Maqedoninë e Veriut është shumë më lehtë për të investuar, në krahasim me disa shtete tjera. (Vila, A.V 2019 marrë nga <http://www.investnorthmacedonia.gov.mk/>).

-Karakteristikat e IHD-ve

Investimet e drejtpërdrejta janë formë të transaksioneve kapitale dhe investimeve nga një investitor, i cili për qëllim ka të krijojë marrëdhënie ekonomike dhe të fitojë të drejtën për të administruar kompaninë ose personin tjetër juridik në të cilin ai ka investuar. Vendet në tranzicion dhe ato në zhvillim, veçanarisht ekonomia e Maqedonisë së Veriut, shpesh nxjerin në pah investimet e huaja direkte si një zgjidhje për të përmirësuar situatën ekonomike në vend. Ekspertiza maqedonase sugjeron një zgjidhje në rritjen e kapacitetit prodhues të vendit. Në vendin tonë investimet e huaja direkte janë si një katalizator i një veprimtarie më të mirë ekonomike. Jo vetëm prodhimi në Maqedoninë e Veriut por edhe tregu financiar tregon nevojë

për rigjallërim dhe nga kjo pikë jo vetëm sektori privat por edhe qeveria e zbatuar përpiqen që të zbatojnë aktivitete të cilat do të tërheqin më shumë investime në vend.

Johnson Matthey ka operacione në mbi 30 vende dhe punëson 11.000 njerëz. Produktet dhe shërbimet e tyre shiten në të gjithë botën në një game të gjërë të industrive të teknologjisë së përparuar. Ata përqendrohen në ajër të pastër, energji të pastër dhe teknologji të ulët të karbonit dhe janë ekspert në aplikimin dhe reciklimin e metaleve të çmuara. Aktivitetet e tyre kryesore janë: prodhimi i katalizatorëve me naftë të rënda dhe sistemeve të kontrollit të ndotjes, sigurim të katalizatorëve dhe përbërësve për qelizat e karburantit, furnizimi me katalizatorë dhe teknologji për proceset kimike, prodhimi i kimikateve të imët, katalizatorëve kimik dhe përbërësve aktiv farmaceutikë, marketing, rafinimi dhe trillimi i metaleve të çmuara. Fabrika e Johnson Matthey në zonën TID në Shkup është projekti i vetëm më i madh i investimeve dhe uzina më e sofistikuar dhe më e përparuar e Johnson Matthey në botë. Investimi kap vlerën 80 milion euro dhe numri i të punësuarve për momentin është mbi 400. Më 9 Maj 2012 kompania shënon një projekt madhor të zgjerimit në Maqedoninë e Veriut me

ndërtimin e një fabrike të dytë të vendosur në zonën teknologjike industriale për zhvillim në Shkup, ky investim me vlerë 60 milion euro i cili do të dyfishojë prodhimin dhe do të rezultojë në krijimin nga më shumë se 100 vende pune dhe u krye në vitin 2013. Ky legjislacion përfshin dy automjete të lehta dhe të rënda, si dhe aplikime jo-rugore siç janë ndërtimi dhe pajisjet bujqësore. Arsyeja se pse ka zgjedhur Maqedoninë e Veriut për investim janë, sepse Maqedonia e Veriut shënon si më e mira për punë, poashtu edhe disponueshmëria e punës duket shumë e mirë për Shkupin si dhe përvoja e kompanisë ka qenë pozitive në vendin tonë.

Kompania “LEAR”

U themelua në vitin 1917 në Detroit, Michigan të Shteteve të Bashkuara si një prodhues i asambleve me tuba, të salduar dhe të stampuar për industrinë e automobilave dhe avionëve. Kompania Lear në Nëntor të vitit 2016 hap fabrikë në Tetovë me një investim mbi 15 milion Euro, me prodhimin e mbulesave të sediljeve. Me suksesin e vazhdueshëm të Lear, në sistemet vertikale të integruara vertikalisht të automjeteve dhe komponentëve, ne jemi të kënaqur që fillojmë operacionet në një vend të përkohshëm në Maqedoninë e Veriut, dhe planifikojmë ndërtimin e bimëve të reja nga mesi i vitit 2016. Në përputhje me pozicionin tonë si lider botëror në luksin e automjeteve dhe shtrimin e performances, ne mirëpresim mundësinë për të shtuar këtë fabrikë të re dhe për të ofruar cilësi dhe shërbim të përkushtueshëm çdo ditë për klientët tanë.

Kompania “EVN- Group”

EVN Group është një prodhues dhe transportues i energjisë elektrike me origjinë austriake, një nga më të mëdhejt në Evropë, që ka mbi 3 milion konsumatorë në 14 vende. Kompania gjithashtu operon në trajtimin e ujit, furnizimin me gaz natyror dhe zonat e biznesit të administrimit të mbeturinave. EVN në Shkup, në tregun e Maqedonisë Veriore është që nga viti 2006. EVN në vitet e fundit ka investuar mbi 350 milion Euro, në përmirësimin e cilësisë së përgjithshme të shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë, si dhe shërbimeve të klientëve. Si rezultat i investimeve të mëdha, strukturës moderne organizative dhe të menaxhimit, si dhe përdorimit të zhvillimeve më të fundit teknologjik në sektorin e furnizimit me energji, imazhi dhe performanca e kompanisë ka ndryshuar plotësisht. Në një kohë të shkurtër EVN Maqedonia u bë një markë e njohur në Maqedoninë Veriore dhe një model i një kompanie moderne e cila mori shumë çmime dhe njohje për funksionimin e saj të përgjithshëm. Në sajë të zbatimit të suksesshëm të riorganizimit dhe transformimit të tij, EVN vendosi një bazë të fortë

për të realizuar qëllimet që i kishte vendosur dhe për tu përballur me të gjitha sfidat në të ardhmen.

Kompania “Rontis Dooel”

Rontis Dooel është një degë e Rontis Corporation dhe operon në Maqedoninë e Veriut që nga fundi i vitit 2006 dhe fillimi i vitit 2007. Rontis Corporation u krijua për herë të parë në vitin 1986 nga një grup profesionistësh me përvojë të konsiderueshme në industrinë e kujdesit shëndetësor dhe me një vision për të ofruar zgjidhje inovative në treg. Që nga themelimi i saj, kompania ka pasur disa moment historike. U ndërtua impianti i parë për pajisjet mjekësore Larisa në Greqi në 1999. Vitin vijues shënoi hyrjen e kompanisë në tregun e ushqimit të foshnjave dhe në 2001 u krijua Klinika e parë e Heamodializës në Loutraki, Greqi. Rontis Dooel është themeluar në 2007 në Veles në Maqedoninë e Veriut dhe ishte impianti i dytë për pajisjet mjekësore. Në 2010 Rontis hyri në kujdesin shëndetësor të konsumatorit në treg. Prodhimi i qumështit Rontamil Infant filloi në 2012, ndërsa në vitin 2014 u krijua një laborator i brendshëm R&D farmaceutik. Disa nga arsyet se pse kompania Rontis Dooel ka zgjedhur Maqedoninë e Veriut për të vepruar ishin: sektori tërheqës i prodhimit, prodhimi me kosto të ulët, kostoja e ulët e punës, vendndodhja dhe taksat e ulëta.

-Aspektet krahasimore të investimeve të huaja në rritjen ekonomike në Maqedoninë e Veriut

-Të dhënat dhe metodologjia

Që rezultatet tona në këtë punim të kenë konfidencë shkencore, do të përdorim metoda të ndryshme si: metoda krahasimore dhe metoda Panel (është një teknikë statistikore që përdor tre qasje: qasja fikse, qasja e rastësishme dhe qasja Husmman-Taylor). Të dhënat e përdorura në ndërtimin e këtij modeli janë mar nga institucionet financiare si nga Bankat Qëndrore dhe nga Banka Botërore si dhe nga enti Statistikor. Si variabla kam vendosur investimet e huaja direkte, GDP si dhe liria ekonomike. Pas përfundimit të evidences empirike do të shohim se si

kanë ndikuar faktorët dhe variablat që kanë pasur një influencë të madhe në zhvillimin ekonomik të vendeve në tranzicion, pozitivisht apo negativisht në rritjen ekonomike të vendit.

-Analiza e regresionit të thjeshtë linear

Regresioni linear ka për synim të modelojë marrëdhënien midis dy variablave duke përshtatur një ekuacion linear me të dhënat e dhëna. Një ose më shumë ndryshore konsiderohet të jetë shpjeguese ose ndryshe e pavarur, si dhe tjetra variable konsiderohet të jetë e varur si psh, një modelues mund të tregojë peshën e individëve në lartësitë duke përdorur një model regresioni linear. Para se të përpiqet të përshtat një model linear me të dhënat e vëzhguara, një modelues duhet së pari të përcaktojë nëse ka ose jo një marrëdhënie midis variablave të interesit. Nëse nuk do të ketë lidhje midis variablave shpjegues dhe te varur kjo (dmth se sfera e shpërndarjes nuk tregon ndonjë tendencë në rrënie ose në rritje), atëherë përshtatja e modelit të regresionit linear me të dhënat ndoshta nuk do të jap model të dobishëm.

Një matje e vlefshme numerike midis dy variablave është *koeficienti i korrelacionit*, i cili është një vlerë midis -1.00 ose 1.00 që tregon forcën e lidhjes së të dhënave të vrojtura për dy variabla. Vlerat -1.00 dhe 1.00 tregojnë korrelacion të fortë ose lidhje funksionale midis dy variablave, vlerat afër 0.00 tregojnë korrelacion të dobët. Vlerat negative tregojnë se është një raport inverz, si dhe vlerat pozitive tregojnë se është raport direkt. Një linjë lineare regression ka formën e këtij ekuacioni:

$$Y = a + bX + \epsilon_i$$

- **Y** është variabli i varur
- **a** është intercept (vlera e Y kur $x = 0$) ose ndërprerja në boshtin Y në populacion-komponenta lineare
- **X** është variabli shpjegues ose e pavarur
- **b** koeficienti i pjerësishëm së populacioni
- **ϵ_i** gabimi i rastësishëm- komponenta e gabimit të rastësishëm(përfshin të gjitha faktorët ose variablat që nuk janë paraparë në model dhe është variable e pa observuar dhe mund të mer vlera pozitive ose negative.




Figura 1. Modeli i thjeshtë i regresionit linear

-Vlerësimi i metodës (OLS)

Pas disa shqetësimeve të përmendura më lart, vlerësimi efikas mund të arrihet duke përdorur metodën e katrorëve të vegjël (OLS). Edhe përkundër paragjytimeve të shumëta, ngjajshëm si në studimet e tjera të dhënat e grumbulluara do të vlerësohen me anë të OLS-së, dhe disa metoda të tjera të regresionit si Fixed Effect dhe RandomEffect. Metodën e katrorëve të vegjël e përdorim për gjetjen e parametrave **a** dhe **b** që minimizojnë shumën e devijimeve të ngritura në katrorë në mes Y_i dhe $\hat{Y}_i$

$$\min \sum (Y_i - \hat{Y}_i)^2 = \min \sum (Y_i - (a + b X_i))^2$$

$$b = \frac{n(\sum XY) - (\sum X)(\sum Y)}{n(\sum X^2) - (\sum X)^2}$$

$$a = \frac{\sum Y}{n} - b \frac{\sum X}{n}$$

- **a** dhe **b** sigurohen përmes gjetjeve të vlerave

- **a** dhe **b** minimizojnë shumën e devijimeve të ngritura në katrorë në mes Y_i dhe $\hat{Y}_i$




Figura 1. Modeli OLS (metoda e katrorëve të vegjël)

-Modelet Fixed dhe Random Effect

Në çdo temë të punuar në lidhje me një model statistikor paraqet një efekt fiks (Model Fixed) apo një efekt të rastit (Random Effect). Modelet me të cilat të gjitha efektet janë fikse atëherë quhen modele të efekteve fikse, ndërsa në mënyrë të ngjajshme, modelet me të cilat të gjitha efektet janë të rastësishme (përveç rastit të një termi të përgjithshëm të përgjimit) quhen modele të efekteve të rastësishme. Modeli Fixed Effect nuk është në korrelacion me modelin Random Effect, nga kjo rrjedh se në modeli Fixed, supozohet të jenë “n” parametra të panjohura që duhet të vlersohen, ndërsa te modeli Random trajtohen si vizatime me nga një shpërndarje me mesataren “ μ ” dhe variancë të cilat janë të pavarura nga variablat shpjeguese.

Në modelin e efekteve fikse, ne ndjekim panel me nën grupe (i-entitet) $i = 1, \dots, n$, gjatë gjithë kohës $t = 1, \dots, T$.

Ekuacioni për modelin e Fixed Effect është:

$$y_{it} = \beta_1 x_{it} + \alpha_i + u_{it}$$

α ($i = 1 \dots n$) - është ndërprerës i panjohur për çdo subject

γ_{it} - është variabël e varur

x_i - përfaqëson variable të pavarur

β_1 - koeficienti i vlerësimit

u_i - gabimi stokastik

Në qoftë se variabla e pashënuar nuk ndryshon në ndikimin e faktorit kohë, atëherë çdo ndryshim në variablen e varur duhet të jetë për shkak të ndikimeve të ndryshme nga këto karakteristika fikse (Stock dhe Watson, 2003).

Kur të dhënave të serive kohore interpretimi i koeficienteve β do të jetë për një vend të caktuar, kur X ndryshon në kohë nga një njësi, ndërsa rritet Y ose zvogëlohet njëra nga njësitet β (Bartels, Brandom, Stony Brook University, 2008)

Nëse kemi arsye për të besuar se ndryshimet në të gjithë subjektet do të kenë ndikim në variabël të nvarur atëherë duhet të përdorim Random Effect.

$$\gamma_{it} = \beta X_{it} + \alpha + u_{it} + \varepsilon_{it}$$

Në modelin Random Effect duhet të bëhen specifike këto karakteristika individuale që mund të ndikojnë tek variablat parashikuese. Efekti Random në ekonometri përdoret atëherë kur nuk ka efekte fikse për anazilën e të dhënave hierarkike. Në avantazhë i këtij modeli është se mund të përfshihen në kohë variablat e pandryshueshme.

Kemi edhe modelet e përziera, ato janë modele të cilët kanë efekte fikse dhe tema të efekteve të rastit, në simbolin e matrices Modelet Fixed, Random Effect dhe Modelet Mikse përfaqësohen nga ekuacionet e më poshtme të modelit

$$Y = X\beta + \varepsilon$$

$$Y = Z\gamma + \varepsilon$$

$$Y = X\beta + Z\gamma + \varepsilon$$

Në këto ekuacione, X dhe Z janë matricat e projektimit ose të regresionit që asociojnë me efektet fikse dhe ato të rastit. Respektivisht vektori β ë një vektor i parametrave të efekteve fikse, dhe vektori γ përfaqëson efektet e rastësishme. Procedurat e modelimit të përziera në softuerin SAS / STAT supozojnë se efektet e rastit γ ndjekin një shpërndarje normale me matricën e variancës-kovariancës G si dhe në shumicën e rasteve, efektet e rastit janë zero.

-Modeli Hausman Taylor

Në mes modelit të efekteve fikse (Fixed Effect) si dhe modelit të efekteve të rastit (Random Effect) vazhdon ende të gjenerohet një debat në mesin e ekonomistëve se cila mund të jetë zgjedhja nga këta dyja. Mundalk (1978) ka argumentuar se modeli i efekteve të rastit mer egzogjenitet nga të gjitha regresorët dhe efektet individuale të rastit, përkundrazi nga modeli i efekteve fikse i cili lejon endogjenitetin e të gjith regresorëve dhe efekteve individuale. Që nga viti 1980 shumica e aplikuesve në ekonomi kanë bërë një zgjidhje midis modeleve, duke u bazuar në testin e modelit Hausman.

Modeli Hausman dhe Taylor (1981) është një hybrid i cili kombinon konzistencën e një modeli të efekteve fikse me efikasitet dhe zbatueshmërinë e një modeli të efekteve të rastit. Testi Hausman emrin e ka marrë nga Jerry A. Hausman dhe është një test statistikor i cili bën testimin e hipotezave. Ky test do na mundëson që të bëjmë testimin e hipotezës zero së koeficienteve të vlerësuar.

Ekuacioni i modelit të Hausman Taylor shkruhet si vijon:

$$y_{it} = X_{it}\beta + Z_i\alpha + u_{it}$$

Hausman Taylor testi ndanë Z dhe X, ku $X = [X_1; X_2]$ dhe $Z = [Z_1; Z_2]$

X_1 është $n \times k_1$,

X_2 është $n \times k_2$

Z_1 është $n \times g_1$

Z_2 është $n \times g_2$ dhe $n-NT$

$$y_{it} = X_{1it}b_1 + X_{2it}b_2 + \alpha_i + Z_{1it}\gamma_1 + Z_{2it}\gamma_2 + \alpha_i + u_{it}$$

Ku, $Y = (Y_1, Y_2)$, $B = (B_1, B_2)$ dhe $\gamma = (\gamma_1, \gamma_2)$

Ajo që e dallon nga të tjerët këtë model është se modeli Hausman Taylor është më efikas dhe se nuk përdorë instrumente të jashtme.

-Dallimi i modeleve “Fixed Effects”, “Random Effects” dhe “Hausman Taylor”

Mënyra më e pëlqyer dhe efektive e zgjedhjes midis dy efekteve “Fixed Effects” dhe “Random Effects” është duke përdorur testin Hausman (1978) . “Hausman Test” është një test kryesisht statistikor që në ekonometri e bën të mundur testimin e hipotezave dhe që emirn e ka marrë nga Jerry A. Hausman. Testi Hausman bën të mundur testimin e hipotezës zero të koeficientëve të vlerësuar nga preventivuesi më efikas siç është “Random Effects”, e që janë të njejta me ato të vlerësuar nga preventivuesi më konsistent siç është “Fixed Effects”. Nëse Hausman Test jep rezultate me P-vlera insignifikante, pra me ‘Prob>ch2’ më e madhe se ‘0.05’ atëherë më e favorshme është që të përdoret Random Effects, por në qoftë se i njejti test do të jep rezultate signifikante, atëherë duhet të përdoret Fixed Effects. E njejta logjikë vlen edhe gjat përdorimit të Hausman Test në vendosjen mes modelit Fixed Effects dhe Hausman-Taylor, ku shenja ‘+’ nënkupton “More-Penrose Pseudoinverse” , e cila paraqet një shprehje në gjuhën matematikore dhe me theks të veçantë të algebrës lineare.

-Interpretimi i rezultateve

Në këtë punim i kemi analizuar këto variabla: rritjen ekonomike, investimet e huaja direkte si dhe lirin ekonomike (freedom). Kryesisht rezultate e më poshtme tregojnë se si investimet e huaja direkte, lirija ekonomike ndikojnë në rritjen ekonomike të vendit tonë. Për të hulumtuar të dhënat në punimin tim kam zgjedhur këto modele si: Fixed Effects, Random Effects, OLS si dhe Hausman Taylor-IV, mirpo rezultatet do ti interpretoj sipas Hausman Taylor-VI pasi ky model konsiderohet të jetë më i besueshmi nga modelet tjera .Përlllogaritjen e koeficientëve të vlerësimit në ekuacionin e regresionit e bëjmë me anë të programit kompjuterik STATA13.

Variablat/Teknika	OLS	Fixed Effects	Random Effects	Hausman Taylor-IV
	GdpGrowth	GdpGrowth	GdpGrowth	GdpGrowth
Gdplog1		0.3956055	0.9966661	0.4057437
FDI	0.1312556	0.0042545	0.0006467	0.0045044
Freedom	-4.634082	0.5490689	-0.996102	0.5099358
Const	423.0492	73.18126	72.1014	-131.1204
Observations	84	83	83	83
R-Squared	0.0846	0.9465	0.9494	
F	0.29			
chi2	0.0000	0.0000	0.0000	0.0000

Burimi: Llogaritur nga vet autori, përmes të dhënave numerike në STATA13

E dimë se zhvillimi ekonomik të një vendi mvaret nga shumë variabla siç janë: liria ekonomike, hapja ekonomike, kreditë bankare, niveli i eksporteve etj. Nga të gjitha variablat ne kemi hedhur si hipoteza dhe kemi analizuar vetëm dy nga këto:

- H1. Rritja e investimeve të huaja në vend ndikon pozitivisht në zhvillimin ekonomik
- H2. Lirija ekonomike ndikon pozitivisht në zhvillimin ekonomik.

Investimet e huaja direkte janë çështje të rëndësishme ekonomike të një vendi, ku në kohët e fundit në veçanti shtetet në zhvillim mundohen sa më shumë për të tërhequr këto lloje investimesh. Investimi i huaj direkt është transferimi i investimeve të huaja direkte jashtë vendit, pasi është një element i rëndësishëm në strategjinë e tyre të përgjithshme për zhvillimin ekonomik.

-Llogaritja e analizës së regresionit(OLS). Duke ju referuar rezultatit të fituar me analizën e bërë të regresionit **(OLS)**, sipas koeficientit **P-value** i cili potencon se vlera e fituar në model duhet të jetë më e vogël se vlera 0.05 që të na tregoj një rezultat të besueshëm. Në analizën që unë kam bërë në punimin tim P-value e cila është paraqitur tek investimet e huaja direkte është 0.016 dhe është më e vogël se vlera 0.05 dhe përmes kësaj mund të konkludojmë se kjo variabël ka një signifikanç të lartë dhe kjo hipotez na pranohet. Ndërsa në modelin ekonometrik tek variabla tjetër, liria ekonomike rezultati i fituar është 0.340 dhe është më e madhe se 0.05 dhe kjo variabël e humb signifikançën.

-Llogaritja e analizës sipas Fixed Effect. Duke ju referuar rezultatit të fituar me analizën e bërë të **Fixed Effect** sipas koeficientit **P-value** i cili potencon se vlera e fituar në model duhet të jetë më e vogël se vlera 0.05 që të na tregoj një rezultat të besueshëm. Vlera tek investimet e huaja e cila është 0.544 dhe është më e lartë se 0.05 përmes kësaj konkludojmë se kjo variabël humb signifikançën, ndërsa tek variabla tjetër tek liria ekonomike vlera është 0.431 dhe është poashtu më e lartë se 0.05 edhe kjo variabël e humb gjithashtu signifikançën.

-Llogaritja e analizës sipas Random Effects. . Duke ju referuar rezultatit të fituar me analizën e bërë të **Random Effect** sipas koeficientit **P-value** i cili potencon se vlera e fituar në model duhet të jetë më e vogël se vlera 0.05 që të na tregoj një rezultat të besueshëm. Vlera tek investimet e huaja e cila është 0.962 dhe është më e lartë se 0.05 përmes kësaj konkludojmë se kjo variabël humb signifikançën, ndërsa tek variabla tjetër tek modeli ekonometrik, tek liria ekonomike vlera është 0.388 dhe është poashtu më e lartë se 0.05 edhe kjo variabël e humb gjithashtu signifikançën.

-Llogaritja se si ndikojnë në GDP investimet e huaja dhe liria ekonomike:

Duke u bazuar në të dhënat e analizës empirike, që na kanë dhënë modelet Random Effect, Fixed Effect dhe Hausman Taylor-IV, vijmë në përfundim se investimet e huaja direkte ndikojnë pozitivisht në zhvillimin apo rritjen ekonomike të një shteti.

- Nëse kemi një rritje prej 1% të indeksit të investimeve 0.004% kjo do të çojë në rritje ekonomike, me gabimin standart të Hausman Taylor= 0.007, Random Effect= 0.013, Fixed Effect=0.006. Sipas këtyre të dhënave të paraqitura duke e marrë parasysh koeficientin Standard Error-it, i cili duhet të jetë më i vogël se 0.05 që rezultati të ketë besueshmëri, në rastin tonë konkret e kemi më të ulët se vlera 0.05 prandaj konkludojmë se indeksi i investimeve ndikon pozitivisht në rritjen ekonomike dhe nga kjo pranohet hipoteza të cilën e kemi parashtruar më parë se *“ rritja e investimeve të huaja në vend do të ndikon pozitivisht në zhvillimin ekonomik”*.

Duke u bazuar në hulumtimet e mëparshme që kanë bërë autor dhe ekonomistë të ndryshëm, do të vërejmë se kanë ardhur në përfundim se edhe liria ekonomike ndikon pozitivisht në rritjen ekonomike të në vendi, apo shteteve në zhvillim. Të dhënat e paraqitura në tabelën e mësipërme që i kemi fituar nga modelet OLS, Fixed Effects, Random Effects dhe modeli i Hausman Taylor-IV do të konstatojmë nëse liria ekonomike ndikon në ulje apo rritje të ekonomisë.

- Nga rezultatet e kalkuluara arrijmë në konkluzion se nëse kemi një rritje prej 1% të indeksit të lirisë ekonomike, kjo do të na çojë në rritjen ekonomike 0.509%. gabimi standard në përlllogaritjen të modeli Hasman Taylor është 0.69, ndërsa te Fixed Effect është 0.69 dhe tek Random Effect është 1.15. Nga e gjitha kjo mund të konkludojmë se hipoteza e parashtruar *“liria ekonomike do të ndikon pozitivisht në zhvillimin ekonomik”* kjo hipotez nuk pranohet.

Konkluzioni

Elementet e motiveve që kërkojnë efikasitet nga një perspektivë e kompanive të huaja janë diskutuar dhe shqyrtuar me shumë kujdes në tezë. Pavarësisht nga vështirësitë që vendi më përball, qeveritë vazhdimisht përpiqen të angazhohen në zhvillimin e strategjive afatgjata që do të ndihmojnë ekonominë e vendit që të zhvillohet më tej. Maqedonia e Veriut ka kaluar disa sfida të vështira që nga koha e pavarësisë së saj, vendi u përball me disa kriza ekonomike, shumica e të cilave erdhën si rezultat i një krize globale dhe një konflikti etnik në vitin 2001. Edhe pse ka kaluar kriza të ndryshme Maqedonia e Veriut ka ndërmarë disa hapa pozitivë në tërheqjen e investitorëve të huaj në industri të ndryshme. Një nga industritë më të zhvilluara në vendin tonë është industria e prodhimit, e cila është industria e dytë më e madhe në vend pas bujqësisë. E gjitha kjo nuk do të ishte e mundur pa nënshkrimin e marrëveshjeve të tregtisë së lire të tilla si: Marrëveshja e Tregtisë së Lire të Evropës Qendrore (CEFTA), Evropa e Lire Marrëveshja Tregtare (EFTA), Marrëveshja e Stabilizimit Asociimit (MSA) dhe shumë të tjera. Me këto marrëveshje Maqedonia e Veriut solli shumë mundësi për zhvillimin e ekonomisë dhe një nga fushat në të cilat ishte e suksesshme është tërheqja e IHD-ve.

Në disa vite të kaluara, shumë investitorë të huaj kanë treguar interes në ekonominë e vendit. Fokusi kryesor për tregun e Maqedonisë së Veriut mbështete në kushtet që vendi u ofron investitorëve të huaj dhe vendodhjes gjeografike të vendit. Të gjitha stimujt që ofrohen për ndërmarjet e huaja marrin vëmendjen e kompanive dhe rrisin atraktivitetin e tregut . në rastin tonë u konfirmua se arsyeja pse kompanitë zgjedhën Maqedoninë e Veriut është kërkimi i efikasitetit, pasi ato janë ndërmarrje të mesme të mëdha që janë përqendruar në gjetjen e kostos së ulët të punës, kosto të ulët të prodhimit, një vendndodhje e mirë dhe taksa të ulëta. Një avantazh tjetër që vendi ofroi janë edhe zonat e lira ekonomike të cilat kanë luajtur një rol thelbësor në tërheqjen e IHD-ve, përkatësisht në suksesin e kompanive të huaja. Përveç motiveve për IHD, edhe pengesat e IHD-ve në pjesën teorike kemi përmendur edhe pengesat e IHD-ve, ku këto pengesa mund të konsiderohen si pika negative të hulumtimit.

Gjatë analizës dhe hulumtimit të hipotezave që kam vendosur në fillim janë përdorur modelet ekonometrike përmes futjes së të dhënave në programin STATA13. Gjatë trajtimit të modelit ekonometrik ne fituam një rezultat i cila paraqet një lidhje pozitive ndërmjet lirisë ekonomike si dhe rritjes ekonomike.

Megjithatë teza siguroi korniza të motiveve të kërkimit të efikasitetit nga këndvështrimi i një kompanie të huaj, ndikimi i marrëveshjeve të tregtisë së lire në tërheqjen e investimeve të huaja direkte dhe nxitjet e vendit drejt investimeve është e vështirë të sigurohet një skanar i

ardhshëm, për shkak të ndryshimit shumë dinamik të mjedisit ekonomik të Maqedonisë së Veriut. Nga analiza e tezës, mund të konfirmojmë se Maqedonia e Veriut është një vend tërheqës për ndërmarrjet e mesme, të përqendruar në prodhim dhe janë të nxitur nga efikasiteti. Rruga e ardhshme e vendit është e vështirë të parashikohet, pasi gjërat po lëvizin me shpejtësi në vendet e Ballkanit dhe ndoshta një ditë Maqedonia e Veriut do ta shohë veten të integruar në familjen e madhe të BE-së.

Literatura/Referencat

1. Nasir Selimi, Tetovë, 2008 “Globalizmi Ekonomik”
2. Edlira Luçi & Dorina Kripa, Tiranë ,2005 “Investime”
3. Stefan Qirici, Tirane,2005 “Ekonomiksi i punes”
4. Abdylmenaf Bexheti & Jeton Mazllami, Tetovë, 2011 “Makroekonomia”
5. Niko Ketri, botimi II 2009 “Ekonomia politike”
6. Nasir Selimi, Tetovë 2010 “Biznesi Ndërkombëtar”
7. Assist. Prof. Dr. Ali Riza SANDALCILAR, “Democracy and Growth: Evidence from Transition Economies”
8. Karen A.Mingst, 2010 “Bazat e marëdhënieve ndërkombëtare”
9. Karel Lannoo, 2015 “ECB Banking Supervision and beyond”
10. Bradlay R Schiller, 7th edition “The economy today”
11. Michael Parkin, 3the edition “Economics”
12. David C.Colander, 3th edition “Economics”
13. Ansel Sharp, Charles A. Register, Paul Grimes, 14th edition “Economics of social issues”
14. Vasilika Kota, 2009 “Determinants of Economic Growth in Albania”
15. Nuri Bashota, Prishtinë, 1998 “Ekonomia Politike”
16. Skender Berisha, Prishtine, 1998 “Mardheniet Ekonomike Nderkombetare”
17. Selman Selmanaj, Prishtine, 1996 “Sisteme ekonomike bashkekohore”
18. George DeMartino ,2011 “Foreign Direct Investment”
19. Myrvete Badivuku-Pantina, Prishtinë 2001 “Korporatat multinacionale dhe roli i tyre ne krijimin e Rendit te Ri Botëror”
20. International Finance Corporation, Washington D.C.1997 “Foreign Direct Investment”
21. Maiko Miyake & Magdolna Sass, Paris, 2000 “ Resent Trends in Foreign Direct Investment ”

22. United Nations, New York and Geneva, 1999 "Trends in International Investment agreements: an Overview"
23. Peter Wahl & Michael Windfuhr, 2002 "Protection and Freedom for foreign Investors"
24. Vito Tanzi & Hamid Davoodi, 1997 "Corruption, Public Investment and Growth"
25. Assist.Prof . Dr. Ali Riza Sandalcilar, 2013 " Democracy and Growth: Evidence from Transition Economies"
26. Robert J. Gordon, 1977 "World Inflation and Monetary Accommodation in Eight Countries"
27. Karel Lanno, 2012 "Rethinking Asset Management: From Financial Stability to Investor Protection and Economic Growth"
28. Robert Gilipin, 2009, "Global Political Economy"
29. Kanga Wafo, "Political Risk and FDI", Konstanz, 1998
30. Adnan jashari, "E Drejta Afariste", Tetovë, 2016

Webfaqe

31. www.scribd.com
32. www.academia.edu
33. www.stat.gov.mk (Enti statistikor I R.M)
34. www.nbrm.mk (Banka Popullore e R.M)
35. www.punetejashtme.gov.al
36. www.finance.gov.mk (Ministria e finances se R.M)
37. www.minfin.gov.al
38. file:///C:/Users/Admin/Desktop/FOREIGN_DIRECT_INVESTMENT_IN_MACEDONIA.pdf
39. file:///C:/Users/Admin/Desktop/FDICapital_Formatted_20170922_Final_W_c7fcb82c-f318-4632-a589-20118eaeebf8.pdf
40. www.academia.edu/6963171/Investimet_e_huaja_direkte

41. www.slideshare.net/Menaxherat/investimet-e-huaja-direkte
42. www.coursehero.com/file/23810630/Investimet-e-Huaja-Direkte/
43. <https://portalb.mk/tag/investime-ne-maqedoni/>
44. http://epi.org.mk/newsDetail_al.php?nwsid=129
45. <https://en.portal.santandertrade.com/establish-overseas/macedonia/investing?>
46. <https://tradingeconomics.com/macedonia/foreign-direct-investment>
47. www.investinmacedonia.com/why-macedonia/growing-fdi
48. www.ceicdata.com/en/indicator/macedonia/foreign-direct-investment
49. www.export.gov/article?id=Macedonia-openness-to-foreign-investment
50. https://eurobc.mk/en/utd_200.html
51. <https://mk.usembassy.gov/sq/business-sq/>
52. [www.ceicdata.com/en/macedonia/gross-domestic-product-by-expenditure-annual/mk- gross-domestic-product-gdp](http://www.ceicdata.com/en/macedonia/gross-domestic-product-by-expenditure-annual/mk-gross-domestic-product-gdp)
53. <https://tradingeconomics.com/macedonia/gdp-growth-annual>
54. <https://www.investopedia.com/articles/basics/11/biggest-risks-international-investing.asp>
55. <https://www.netherlandsworldwide.nl/countries/north-macedonia/doing-business/why-invest-in-macedonia/labor-market>
56. https://www.researchgate.net/publication/261510880_The_Characteristics_of_Foreign_Direct_Investment_Intensification_Policy
57. <https://www.uniassignment.com/essay-samples/economics/>
58. https://www.nordeatrade.com/en/explore-new-market/north-macedonia/investment?vider_sticky=oui
59. <https://tradingeconomics.com/country-list/foreign-direct-investment>
60. <https://tradingeconomics.com/country-list/gdp>
61. <https://www.heritage.org/index/?version=598>

Llogaritjet në Appendix

Tabela A1. Shtetet e përfshira në modelin empirik

Numri	Shtetet e analizuara në tranzicion
1	Shqipëria
2	Maqedonia e Veriut
3	Sllovenia
4	Kroacia
5	Hungaria
6	Turqia

Tabela A2. Përshkrimi i Variablave

Numri	Variablat	Detajet	Kodi
1	Rritja Ekonomike	Rritja Ekonomike, GDP	GDP
2	Investimet e Huaja Direkte	Indeksi I investimeve të huaja	FDI
3	Liria Ekonomike	Indeksi i Lirisë Ekonomike	EFI

Tabela A3. Rezultatet e Regresionit

Variablat/Teknika	OLS	Fixed Effects	Random Effects	Hausman Taylor-IV
	GdpGrowth	GdpGrowth	GdpGrowth	GdpGrowth
Gdplog1		0.3956055	0.9966661	0.4057437
FDI	0.1312556	0.0042545	0.0006467	0.0045044
Freedom	-4.634082	0.5490689	-0.996102	0.5099358
Const	423.0492	73.18126	72.1014	-131.1204
Observations	84	83	83	83
R-Squared	0.0846	0.9465	0.9494	
F	0.29			
chi2	0.0000	0.0000	0.0000	0.0000
Teknika	OLS	Fixed Effects	Random Effects	Hausman Taylor

Appendix. B

Summary Statistics

```
. summarize gdp fdi freedom
```

Variable	Obs	Mean	Std. Dev.	Min	Max
gdp	84	176.4466	283.4127	6.86	950.58
fdi	84	392.963	565.7582	-1617.8	2349.6
freedom	84	64.34524	6.268056	51.1	82.9

Correlation

```
. correlate gdp fdi freedom  
(obs=84)
```

	gdp	fdi	freedom
gdp	1.0000		
fdi	0.2724	1.0000	
freedom	-0.1289	-0.1009	1.0000

OLS

```
. regress gdp fdi freedom
```

Source	SS	df	MS	Number of obs = 84		
Model	563838.955	2	281919.477	F(2, 81) = 3.74		
Residual	6102950.51	81	75345.068	Prob > F = 0.0279		
Total	6666789.46	83	80322.7646	R-squared = 0.0846		
				Adj R-squared = 0.0620		
				Root MSE = 274.49		

gdp	Coef.	Std. Err.	t	P> t	[95% Conf. Interval]	
fdi	.1312556	.0535277	2.45	0.016	.0247523	.2377588
freedom	-4.634082	4.831435	-0.96	0.340	-14.24712	4.978959
_cons	423.0492	315.1268	1.34	0.183	-203.9543	1050.053

Random Effect

```
. xtreg gdp gdplog1 fdi freedom, re
```

```
Random-effects GLS regression                Number of obs    =      83
Group variable: countrysum                  Number of groups   =       6

R-sq:  within = 0.6413                      Obs per group: min =      13
        between = 0.9994                      avg =      13.8
        overall = 0.9494                      max =      14

Wald chi2(3) = 1482.13
corr(u_i, X) = 0 (assumed)                  Prob > chi2       = 0.0000
```

gdp	Coef.	Std. Err.	z	P> z	[95% Conf. Interval]	
gdplog1	.9966661	.0271959	36.65	0.000	.9433631	1.049969
fdi	.0006467	.0134868	0.05	0.962	-.025787	.0270804
freedom	-.996102	1.154494	-0.86	0.388	-3.258869	1.266665
_cons	72.1014	75.62586	0.95	0.340	-76.12256	220.3254
sigma_u	0					
sigma_e	28.567923					
rho	0	(fraction of variance due to u_i)				

Fixed Effects

```
. xtreg gdp gdplog1 fdi freedom, fe
```

```
Fixed-effects (within) regression      Number of obs   =      83
Group variable: countrysum            Number of groups  =       6

R-sq:  within = 0.6512                  Obs per group: min =      13
      between = 0.9992                      avg =     13.8
      overall  = 0.9465                      max =      14

                                         F(3,74)         =     46.04
corr(u_i, Xb) = 0.9409                  Prob > F         =     0.0000
```

gdp	Coef.	Std. Err.	t	P> t	[95% Conf. Interval]	
gdplog1	.3956055	.0349374	11.32	0.000	.3259912	.4652199
fdi	.0042545	.0069847	0.61	0.544	-.0096629	.0181718
freedom	.5490689	.6928214	0.79	0.431	-.8314079	1.929546
_cons	73.18126	44.44081	1.65	0.104	-15.36899	161.7315
sigma_u	192.17489					
sigma_e	28.567923					
rho	.97837922	(fraction of variance due to u_i)				

```
F test that all u_i=0:      F(5, 74) =      67.83      Prob > F = 0.0000
```

Modeli përfundimtarë për komentim të rezultateve

Modeli Hausman Taylor-IV

```
. xtaylor gdp gdplog1 fdi freedom countrynum, endog (fdi freedom)
```

```

Hausman-Taylor estimation      Number of obs      =      83
Group variable: countrynum    Number of groups   =       6

                                Obs per group: min =      13
                                avg =      13.8
                                max =      14

Random effects u_i ~ i.i.d.    Wald chi2(4)        =    150.93
                                Prob > chi2           =     0.0000

```

gdp	Coef.	Std. Err.	z	P> z	[95% Conf. Interval]	
TVexogenous						
gdplog1	.4057437	.0350416	11.58	0.000	.3370634	.474424
TVendogenous						
fdi	.0045044	.0070575	0.64	0.523	-.0093281	.0183369
freedom	.5099358	.6999252	0.73	0.466	-.8618924	1.881764
TIexogenous						
countrynum	58.47796	35.49687	1.65	0.099	-11.09462	128.0505
_cons	-131.1204	145.7417	-0.90	0.368	-416.7689	154.5281
sigma_u	143.28466					
sigma_e	28.005877					
rho	.96320264	(fraction of variance due to u_i)				

Note: TV refers to time varying; TI refers to time invariant.